

VENDIM
Nr. 124, datë 1.3.2023

PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI TË MINISTRISË SË SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE, PËR SHËRBIMIN SOCIAL SHTETËROR, TË OBJEKTEVE “GODINA NR. 1 (3 KATE+1 KAT NËNTOKË)” DHE “GODINA NR. 3 (6 KATE + 1 KAT NËNTOKË)”, TË KONFISKUARA, PËR INTERES PUBLIK, ME ADRESË NJËSIA ADMINISTRATIVE GOLEM, BASHKIA KAVAJË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, “Për pronat e paluajtshme të shtetit”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, për Shërbimin Social Shtetëror, të objekteve “Godina nr. 1 (3 kate + 1 kat nëntokë)” dhe “Godina nr. 3 (6 kate + 1 kat nëntokë)”, të konfiskuara, për interes publik, me adresë njësi administrative Golem, Bashkia Kavajë, sipas planvendosjes, që i bashkëlidhet këtij vendimi.


2. Autoriteti përfitues, sipas pikës 1, të këtij vendimi, ngarkohet të aplikojë nëpërmjet sistemit “e-leje” për miratimin e lejes së zhvillimit, si dhe lëshimin e certifikatës së përdorimit.

3. Autoritetit përfitues, sipas pikës 1, të këtij vendimi, i ndalohet t’i tjetërsojë, t’u ndryshojë destinacionin apo t’ua japë në përdorim të tretëve objektet e përcaktuara në pikën 1, të këtij vendimi.

4. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Shërbimi Social Shtetëror dhe Agjencia Shtetërore e Kadastrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku



PLANI I VENDOSJES SE STRUKTURES SHK 1 500

[illegible]

SIFENIM TE MUND SIFENIM:

Ne plantacdoes jana 13 objektu (1+1+1+1) mly godnau e "Mak Albana" me gerifikau pomsse dnu 07.11.2014 (n total 8900.23 m²). Refektu aktses se Induktsioe m Maktrm Pr Prot 2080.1 dnu 25.11.2022 dnu plantacdoes godnau 1 ka sap mly dnu 409.3 m², godnau 3 ka sap mly dnu mly dnu 1360.16 m², dnu aktsipak sap mly dnu 9410 m², dnu sap pomsse 3650 m².

ORTOTOFO E VENDORI DI SE OGGETTI SHK 12000

AGENCE ZIVILNA

Mitteilung des Vordrucks der K.N.T.-Nr. 02, Datum 26.12.2012

